



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 27.07.2024

Nr: 5

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E ORARIT TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 244, datë 5.7.2024 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, nenit 11, pika 1, dhe nenit 20, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Qendrat e votimit, ku do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024, hapen në ora 07:00 dhe mbyllen në ora 19:00.
2. Ngarkohen administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KZAZ nr.88 dhe komisionet e qendrave të votimit të KZAZ nr. 88, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar

Data: 27.07.2024 Nr:5
Ora:11:00



“Për miratimin e orarit të votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”